



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/ 6779 /2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN QERSHOR 2026

Hani i Elezit, 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Qershor 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Qershor 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Maj 2026,
 - Barazimi me Thesar periudha Janar-Maj 2026,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Maj 2026 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Maj 2026, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Maj 2026,
- Pranimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare nga ZKA për 2025,
- Mbajtja e 4 dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029,
- Hartimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2027-2029 dhe publikimi në web faqen e Komunës në dy formate: word dhe pdf,
- Hartimi i procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore dhe publikimi në web faqe edhe me listat e pjesëmarrjes,
- Hartimi i KAB 2027-2029 dhe dërgimi për shqyrtim në KPF dhe Kuvend Komunal,
- Është përgatitur material shtesë me listën e projekteve kapitale të propozuara nga dëgjetet buxhetore dhe është dërguar për KPF dhe Kuvend Komunal,
- Përgatitja e kërkesës për rialokimin e mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Investime Kapitale,
- Aprovimi i bartjes së bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 nga MFPT dhe përditësimi i të dhënave në SIMFK,
- Hartimi i planit të veprimit të zbatimit të rekomandimeve nga DAB-MFPT,
- Miratimi i KAB 2027-2029 në Kuvend Komunal dhe dorëzimi në DB-MFPT,
- Miratimi i kërkesës për rialokimin e mjeteve në kuadër të kategorisë Investime Kapitale dhe dorëzimi në DB-MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN QERSHOR 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Realizimi Qershor 2026
Paga dhe shtesa	210,262.92
Mallra dhe shërbime	35,080.69
Shpenzime komunale	5,290.77
Subvencione dhe trans.	59,975.00
Shpenzime kapitale	2,649.32
TOTAL	313,258.70

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00. Gjatë muajit Qershor nuk kemi pasur regjistrim të të hyrave vetanake të inkasuara si pasojë e mungesës së zyrtarit të regjistrimit të të hyrave vetanake. Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,
- Publikimi i një njoftimi për pagesën e kështit të parë të faturës së tatimit në pronë.

Drejtore për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

